

Statistikat e kulturës

Tremujori I – 2019

Tiranë, më 2 Maj 2019: Në tremujorin e parë 2019, numri i shfaqjeve kulturore ishte 308, duke shënuar 8 shfaqje më shumë, në krahasim me tremujorin e parë 2018. Në institucionet e artit dhe kulturës, në tremujorin e parë 2018, janë organizuar 17 premiera, 10 premiera më pak, krahasuar me tremujorin e parë 2018.

Në tremujorin e parë 2019, numri i spektatorëve është 67.609, duke pësuar rritje me 1,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Pjesëmarrja mesatare në tremujorin e parë 2019 është 220 spektatorë për shfaqje dhe ka pësuar ulje me 0,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018.

Institucione të artit dhe kulturës

Për tremujorin e parë 2019, Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve, me 145 të tilla, megjithatë ka pësuar rënie prej 2,7 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018. Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor ka realizuar numrin më të lartë të premierave, 10 premiera, 6 më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve/premierave në institucionet kulturore

Numri i shfaqjeve/premierave	Shfaqje			Premiera		
	Tr.1-2018	Tr.1-2019	Ndryshimi tremujor në %	Tr.1-2018	Tr.1-2019	Ndryshimi tremujor në %
Teatri Kombëtar Popullor	44	57	29,5	4	1	-75
Teatri Kombëtar Eksperimental	149	145	-2,7	6	6	0
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	24	35	45,8	16	10	-37,5
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	51	35	-31,4	-	-	-
Cirku Kombëtar	32	36	12,5	1	0	-100
Shfaqje kulturore/premiera gjithsej	300	308	2,7	27	17	-37

Për tremujorin e parë 2019, Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka numrin më të lartë të spektatorëve, me 22.765 të tillë; megjithatë, ka shënuar një rënie prej 18,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Rritjen më të lartë në përqindje për numrin e vizitorëve, në tremujorin e parë 2019 e ka patur Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor me 54,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve në institucionet kulturore

Numri i spektatorëve	Tr.1-2018	Tr.1-2019	Ndryshimi tremujor në %
Teatri Kombëtar Popullor	13.963	15.735	12,7
Teatri Kombëtar Eksperimental	28.068	22.765	-18,9
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	12.256	18.950	54,6
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	5.079	3.424	-32,6
Cirku Kombëtar	7.378	6.735	-8,7
Numri i spektatorëve gjithsej	66.744	67.609	1,3

Numri mesatar i spektatorëve për shfaqje ka pësuar një rënie të lehtë, nga 222 spektatorë për shfaqje që ishte në tremujorin e parë të vitit 2018, në 220 spektatorë për shfaqje, në tremujorin e parë 2019. Ulja është në masën 0,9 %.

Fig.1 Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje në institucionet kulturore



Trashgimi kulturore

Numri i vizitorëve në muze, në tremujorin e parë 2019 është 25.916, duke shënuar rritje me 5,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018.

Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve ka një rritje prej 2,5 % ndërmjet tremujorit të parë 2019 dhe të njëjtit tremujor në vitin 2018.


Numri i vizitorëve në parqe arkeologjike, në tremujorin e parë 2019 është 19.881, me rritje prej 43,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë, të vitit të mëparshëm.

Në tremujorin e parë 2019, numri i vizitorëve të huaj në muze, parqe dhe kala ishte 15.846, duke shënuar një rritje me 27,4 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018. Përqindja më e lartë e vizitorëve të huaj është në muze, përkatësisht 27,4 % të huaj nga totali i vizitorëve në muze.

Tab.3 Vizitorë në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike

Numri i vizitorëve	Tr.1-2018	Tr.1-2019	Ndryshimi tremujor në %
Muze	24.477	25.916	5,9
Kala e Monumente të tjera	18.075	18.518	2,5
Parqe Arkeologjike	13.872	19.881	43,3
Numri i vizitorëve gjithsej	56.424	64.315	14,0

Fig.2 Përqindja e vizitorëve të huaj në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike



Biblioteka Kombëtare

Numri i shërbimeve të njësive bibliotekare, ka patur një rritje prej 1,2 % në tremujorin e parë 2019, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2018; ndërsa numri i veprimtarive kulturore dhe shkencore ka rënë me 43,5 %.

Në tremujorin e parë 2019, numri i frekuentuesve në Bibliotekën Kombëtare ka qënë 30.669, duke shënuar një rritje me 64,3 %, karahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në tremujorin e parë 2019, në Bibliotekën Kombëtare janë afishuar 6.574 botime, 55,7 % më shumë në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2018. Nga këto botime 1.233 ishin tituj të rinj dhe 5.341 ekzemplarë të rinj.

Tab.4 Frekuentimi dhe botimet në Bibliotekën Kombëtare

Treguesit	Tr.1-2018	Tr.1-2019	Ndryshimi tremujor në %
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	19.728	19.971	1,2
Frekuentimi	18.662	30.669	64,3
Veprimtari Kulturore dhe Shkencore	62	35	-43,5
Numri i botimeve	4.222	6.574	55,7
Numri i titujve të rinj gjatë vitit	815	1,233	51,3
Numri i ekzemplarëve të rinj gjatë vitit	3.407	5.341	56,8

Shënime metodologjike

Në institucionet qendrore të artit përfshihen: Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP), Teatri Kombëtar (TK), Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" (TKEKS), Galeria Kombëtare e Arteve (GKA), Cirku Kombëtar (CK), Arkivi Qendror Shqiptar i Filmit (AQSHF), Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave (QKKFTK), Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala.

Në totalin e muzeve, kalave dhe parqeve arkeologjike janë përfshirë institucionet si:

Muze	Kala e monumente të tjerë	Parqe arkeologjik
Muzeu Historik Kombëtar Tiranë	Kalaja Berat	Parku Kombëtar Butrint
Muzeu Arkeologjik Durrës	Kalaja Gjirokastrë	Parku Arkeologjik Apoloni
Muzeu i Pavarësisë Vlorë	Kalaja e Portopalermos	Parku Arkeologjik Bylis
Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë	Kalaja e Kaninës	Parku Arkeologjik Shkodër
Muzeu Etnografik, Krujë	Kalaja e Himarës	Parku Arkeologjik Lezhë
Muzeu Etnografik Berat	Amfiteatri	Parku Arkeologjik Amantia
Muzeu Ikonografik Onufri, Berat	Manastiri i 40 Shënjtoreve	Parku Arkeologjik Orikum
Muzeu i Artit Mesjetar, Korçë	Manastiri i Mesopotamit	Parku Arkeologjik Finiq
Muzeu Arkeologjik, Korçë		Parku Arkeologjik Antigone
Muzeu Arsimit, Korçë		
Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi		
Muzeu Kombëtar i përgjimeve " Shtëpia me Gjethe"		

Burimi i të dhënave: Të dhënat e statistikave të kulturës sigurohen nga Ministria e Kulturës